



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë më ____ .01.2022

V E N D I M

Nr. 1, datë 12.01.2022

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK
2023 - 2024**

Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenet 98 e 99 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 9, pika 2, gërma "P", të Statutit të Kolegjit Universitar "Reald", miratuar me Urdhër nr. 147, datë 13.03.2017 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Senati Akademik në Kolegjin Universitar "Reald",

V E N D O S I :

1. Të miratojë "**Kriteret e pranimit të studentëve për vitin akademik 2023 – 2024**", në Kolegjin Universitar "Reald", si më poshtë:
 - a. Në programet profesionale të studimit 2 (dy) vjeçar, kriter i pranimit është përfundimi i shkollës së mesme.
 - b. Në ciklin e parë të studimeve "Bachelor", në të gjitha programet, kriter i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
 - c. Në programet e integruara të ciklit të dytë, kriter i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
 - d. Në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave", kriter i pranimit është përfundimi i ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në të njëjtën degë ose në degë tjetër të përafërt.
 - e. Renditja e studentëve fitues për regjistrim të bëhet në rend zbritës duke filluar nga nota mesatare më e lartë.
2. Ky vendim të hidhet në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "Reald", si dhe t'i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Prof. Dr. Spiro CAUSHI